

VENDIM
Nr. 671, datë 30.10.2024

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË
ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI
NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, ME VENDNDODHJE NË DIGËN E
ZADEJËS, HEC “VAU I DEJËS”, QARKU SHKODËR, NGA KORPORATA
ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE (KESH) SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 2, të nenit 21, të vendimit nr. 822, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në digën e Zadejës, Hec “Vau i Dejës”, qarku Shkodër, nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a., me elementet, si më poshtë vijon:

- a) Emri i aplikuesit: Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a.;
- b) NIPT/NUIS: J61817005F;
- c) Tipi i centralit: fotovoltai;
- ç) Kapaciteti i instaluar: 8.25 mw;
- d) Afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: Koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit fotovoltai do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: Në digën e Zadejës, HEC “Vau i Dejës”, qarku Shkodër;
- e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- ë) Koordinatat e tokës dhe planvendosja, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;
- g) E drejta për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në digën e Zadejës, HEC “Vau i Dejës”, qarku Shkodër, e dhënë sipas këtyre rregullave, mund të transferohet te një subjekt i tretë, vetëm me miratimin e Këshillit të Ministrave;
- gj) Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a., ka detyrimin që:
 - i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltai;
 - ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;
 - iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës, ndërmjet shoqërisë (KESH) sh.a. dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ANEKSI 1

KOORDINATAT E CENTRALIT ELEKTRIK FOTOVOLTAIK NË DIGËN E ZADEJËS, HEC “VAU I DEJËS”, QARKU SHKODËR, NGA KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (KESH) sh.a.				
Koordinatat KRGJSH	Pika 1	Pika 2	Pika 3	Pika 4
x	468901.86	469203.56	469088.76	468889.96
y	4653927.44	4653724.44	4653625.74	4653753.84

